



FTESË PËR PJESËMARRJE NË KURSIN NDËRKOMBËTAR

“PEDAGOGËT E RINJ NË SHEKULLIN XXI”

Agjencia e Bashkëpunimit për zhvillimin Ndërkombëtar të Izraelit (MASHAV) në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit Ndërkombëtar për Arsimin “A. Ofri MASHAV” organizon kursin ndërkombëtar *“Pedagogët e rinj në shekullin XXI- Për mësuesit e shkencave të edukimit”*, i cili do të mbahet në Jerusalem, Izrael, në datat 25 nëntor – 14 dhjetor 2018.

Kursi i ofruar nga Qendra Ndërkombëtare e Edukimit “A. Ofri MASHAV” paraqet një program të integruar e të përqëndruar në qasjet inovative pedagogjike në arsim, ide të reja praktike, rritje profesionale, praktikë dhe ekesperiençë, ekspozim ndaj mjeteve metodologjike që po përdoren në kuadër të përvojave të fituara gjatë procesi mësimor.

Në këtë kurs ndërkombëtar mund të aplikojë stafi i arsimit të lartë si: lektorë, rektorë, hartues të kurrikulave, ekspertë të edukimit profesional, ose pedagogë të angazhuar në institucionet e trajnimit të mësuesve.

Bursa mbulon kostot e programit të trajnimit që përfshijnë leksione dhe vizita në terren, shpenzimet për akomodimin, sigurimin shëndetësor si dhe transportin e brendshëm. Ndërsa shpenzimet për transportin ndërkombëtar do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e kursit.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe kushteve që duhet të plotësojë kandidati, ju lutemi referojuni adresave të mëposhtme në web:

<http://mashav.mfa.gov.il/MFA/mashav/Courses/Pages/default.aspx>

<http://embassies.gov.il/pretoria/Mashav/calendar-of-Mashav/SiteAssets/Pages/New-pedagogies-in-the-21st-century---for-Higher-Education-Teachers/New%20pedagogies%20in%20the%2021st%20century%20-%20for%20Higher%20Education%20Teachers.pdf>

Dokumentacioni i plotë dhe formularët e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Ambasadës së Izraelit në Tiranë si dhe në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit “A. Ofri MASHAV” brenda **datës 25.09.2018** që është edhe afati i fundit për aplikim.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS